



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.20

Prishtinë, më 15.07.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi, Mufera Sinik, Shpejtim Bulliqi, Shukrije Bytyqi dhe Teuta Haxhiu.

Mungoi: Srdjan Popović

Pjesëmarrës të tjerë: Blendina Krasniqi-UNDP (praktikante), Feim Hoxha-MKRS, Valon Kashtanjeva-MKRS, Bekim Kodraliu-OSBE, Arta Krasniqi-OSBE, Fitore Ademi-RTV21, Tringa Bytyqi- GLPS, Ukë Gashi-ZPRK.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri.

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapimbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Nait Hasani, tha se Komisioni ka marr Projektligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe ne kërkojmë që ky Projektligj të bëhet i ri ose direktivat e përafërta me ato të BE-së, të jenë të plota në mënyrë që mos të kemi ndryshime kaq të shpeshta të ligjeve. Ai theksoi se qëllimi ynë është që ligjet të mbesin pa u ndryshuar për shumë vite.

Feim Hoxha, tha se me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për zhvillimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, MKRS mbetet e përkushtuar që të krijoj dhe zhvilloj politika të qëndrueshme në funksion të përmbushjes së objektivave ligjore. Ai theksoi se përafrimi i legjislacionit është një nga detyrat me të cilat ne si Ministri jemi përkushtuar në vazhdimësi. Në fushën e së drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta ekzistojnë disa direktiva të BE-së me të cilat shtetet anëtare kanë bërë harmonizimin e legjislacionit të tyre në këtë fushë dhe nga kjo ka rezultuar që të bëhet ndryshimi i këtij ligji me qëllim që të jemi në hap me ndryshimet që ndodhin në legjislacionin e BE-së dhe atë ndërkombëtar. Ai theksoi se në Ligj nuk ka ndryshime përmbajtësore dhe ky ligj është harmonizuar plotësisht me direktivat e BE-së përveç një direktive me të cilin pritet të merremi në vitet e ardhshme. Ai theksoi se në këtë ligj janë rreth 200 nene dhe prej tyre 33 kanë pësuar plotësim ndryshime, që nuk është numër shumë i madh në krahasim me përmbajtjen e ligjit dhe për hir të rëndësisë që ka ky projektligj kërkojmë që të miratohet në parim.

Valon Kashtanjeva, tha se arsyeja pse ne jemi përcaktuar që të ketë ndryshim plotësim të këtij ligji është për shkak se ligji në substancë nuk ndryshon, ndryshimet kryesisht kanë të bëjnë me plotësimin e ligjit me definicione, përveç ndryshimeve në nene në këtë projektligj ka edhe disa nene të reja për shkak të një direktive të re të nxjerr nga BE-ja, direktiva për përdorimin e veprave jetime nga ana e institucioneve publike dhe kemi kërkuar që disa nene të reja të shtohen me qëllim që ligji të jetë i harmonizuar. Ai tha se ligji tani është në harmoni me 9 direktiva të BE-së me përjashtim të një direktive e cila nuk është harmonizuar ende as nga vendet anëtare dhe ka mundësi që kjo direktivë të bëhet një ligj i ri për shkak se rregullon sferën e menaxhimit kolektiv të të drejtave të autorit. Ai theksoi se përveç direktivës mbi përdorimin e veprave jetime në të gjitha direktivat tjera ka vetëm ndryshime të vogla por që patjetër është dashtë të përmenden direktiva.

Shpejtim Bulliqi, tha se në bazë të informatave mbi volumin e këtij ligji, këtu kemi të bëjmë me një plotësim ndryshim të vogël në ligj. Ai theksoi se ndryshimet janë relativisht të komplikuara

por meqë bëhet fjalë për harmonizim me direktivat e BE-së propozoi që ta miratojmë në parim dhe ta përcjellim për Kuvend.

Teuta Haxhiu, tha se edhe në mandatin e kaluar nuk jam pajtuar me volumin e madh të këtij ligji dhe pyeti se a e kanë edhe shtetet tjera kaq shumë të ngarkuar këtë ligj. Ajo theksoi se do të ishte më mirë që Ministria ta kthej këtë ligj dhe të bëjë një ligj të ri që do të ishte më i thjesht për implementim.

Valon Kashtanjeva, tha se për shkak se ky ligj rregullon fusha mjaft specifike me akte ndërkombëtare ose me direktiva të BE-së është e pamundur që të largohen nene.

Bekim Haxhiu, tha se ligji nuk ka shumë ndryshime nëse e marrim parasysh volumin e tij por pasi që qëllimi i ligjit është rregullimi i fushës së të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta sipas direktivave të BE-së, do të duhej të ishte më mirë i harmonizuar. Në vazhdim theksoi se të gjithë ata që kërkojnë të drejtën e autorit përmes gjykatës nuk iu përfillen kërkesat e tyre dhe vendimet janë të stërzgjatur prandaj ai propozoi që afat kohorë të rregullohen me ligj si procedura një apo dy vjeçare dhe të drejtat e autorit të trajtohen si të drejta komerciale në mënyrë që të dimë se cilit sektor të Gjykatës i takojnë. Ai theksoi se duhet të precizohet në ligj që, ky ligj harmonizohet me direktivat e BE-së dhe pastaj Ministria ti publikoj këto direktiva në WEB site e saj.

Nait Hasani, pyeti se si mbrohen të drejtat e autorit nëse në nenin 45 lejohet kopjimi i veprave të artit dhe incizimet kalimtare pa lejen e autorit .

Valon Kashtanjeva, tha se incizimet kalimtare kanë të drejtë ti transmetojnë përkohësisht programet të cilat i imitojnë por fillimisht duhet të kenë marrëveshje me mbajtësin e së drejtës së autorit dhe në bazë të direktivës së BE-së parashihet që koha e ruajtjes së incizimit të jetë 12 muaj.

Ismajl Kurteshi, tha se ligji në tërësi edhe propozimet për plotësim dhe ndryshim mbulojnë një fushë specifike që edhe kërkon njohuri specifike dhe të veçanta prandaj ai propozoi që në të ardhmen të organizohet një dëgjim publik në të cilin do të ftohen ekspert të fushës dhe pastaj këshillat e tyre Komisioni ti marr parasysh për leximin e dytë dhe për propozimet që do ti dërgoj në Kuvend.

Shukrije Bytyqi, tha se i kam analizuar këto plotësim ndryshimet dhe kam vërejtje sa i përket lidhshmërisë së fjalëve në këtë projektligj. Ajo propozoi që te neni 12 pika 1.1 për deponitë ligjore fjala “librari” të zëvendësohet me “biblioteka”, te pika 1.2 shoqata e botuesve dhe autorëve të zëvendësohet me fjalën “shoqata e shkrimtarëve”, në pikën 2.2 dhe 4.3 të largohet fjala "librari", te neni 14 pika 6A për afatin e mbrojtjes së veprave muzikore të autorit fjala "autor" të zëvendësohet me fjalën “person”. Ajo theksoi se duhet të mbajmë një dëgjim publik në mënyrë që edhe ne ti shohim propozimet e eksperteve.

Nait Hasani, tha se ne si Komision pajtohemi që në parim ta përcjellim këtë projektligj për seancën e radhës.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

Nait Hasani, tha se kemi kërkuar që për këtë Projektligj GIZ-i të na mbështes me ekspert dhe nëse na ofrohet mbështetje ne mund të bëjmë plotësimin e këtij Projektligji por nëse jo atëherë ne nuk kemi mundësi të marrim ekspert të Kuvendit.

Shpejtim Bulliqi, tha se duhet te angazhojmë një ekspert sa i përket këtij Projektligji dhe propozoi që të kërkohej nga GIZ-i mbështetje për organizimin e një vizite në ndonjë Akademi jashtë vendit, si në Slloveni, Kroaci ose Francë.

4. Të ndryshme

Nait Hasani, tha se ne si Komision duhet të shqyrtojmë vendimin e ministrit për themelimin e Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj dhe të marrim një qëndrim. Ai theksoi se ministri e ka marr këtë vendim në bazë të kërkesës së Fakultetit Teknik dhe mbështetjes së ofruar nga të gjitha partitë politike në Ferizaj.

Bekim Haxhiu, tha se e përkrahi iniciativën e Fakultetit dhe të Ministrisë, decentralizimi i kësaj sfere të arsimit është në interes të qytetarëve dhe kjo do të ndikoj drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të Ferizajt ashtu siç ka ndikuar edhe themelimi i Universiteteve të tjera në regjionet e tjera në Kosovë. Ai theksoi se me mbështetje nga Ministria e Arsimit këto Universitete gradualisht mund të renditen në listat botërore të Universiteteve Evropiane.

Ismajl Kurteshi, tha se edhe unë jam përherë për hapjen e shkollave të reja mirëpo këtu po bëhet fjalë për gradimin e një Fakulteti i cili duhet ti plotësoj kushtet para se të gradohet dhe ne duhet të angazhohemi shumë për ngritjen e cilësisë dhe plotësimin e kushteve para se ti gradojmë këto Fakultete. Në vazhdim tha se për të vendosur se a jemi pro apo kundër ne do të duhej të bazohemi në arsyetimin që vjen nga propozuesi dhe arsyetimi i propozuesit këtu është vetëm një fjali nga e cila nuk kuptohet asgjë. Ai theksoi se kjo çështje duhet ti kthehet Ministrisë dhe ta shqyrtojë mirë situatën sepse këto lloj propozimesh nuk janë serioze.

Teuta Haxhiu, tha se edhe unë jam që Universitetet Publike të jenë edhe në ato regjione që vlerësohet që është me interes për të gjithë qytetarët por duhet gjithmonë të kontrollohet edhe cilësia e tyre. Unë pajtohem që ky Fakultet të kaloj nëpër kritere që ta meritoj emërtimin Universitet dhe duhet të kërkojmë nga Agjencia për Akreditim që ta kemi listën e institucioneve të arsimit të lartë të akredituara dhe të jenë në dijeni edhe qytetarët për to. Ajo pyeti se a ka kuadro të mjaftueshme ky Fakultet për degët e hapura atje sepse kam dëgjuar që është hapur konkurs për pranim të kuadrove.

Nait Hasani, tha se në nenin 9 të ligjit për Arsimin e Lartë përcaktohet qartë se bartësit publik të arsimit të lartë mund të krijohen vetëm me vendimin e ministrit dhe ratifikohet nga Kuvendi.

Shukrije Bytyqi, tha se edhe unë pajtohem që të ketë Universitete por jo në këtë formë që po bëhet tani, pa i plotësuar kushtet. Ajo theksoi se Ministria duhet të na jap arsyetim më të mirë se sa i plotëson kushtet Fakulteti i Ferizajt që të bëhet Universitet.

Shpejtim Bulliqi, tha se e përkrahi këtë iniciativë edhe pse jemi duke i shndërruar ish shkollat e larta pedagogjike në Universitete. Ai theksoi se ky Universitet mund të ketë probleme me kuadro sepse po e shohim që edhe me këto kuadro që i ka ekzistojnë probleme.

Salih Morina, tha se ne e kemi një vendim që na është sjellë nga Ministria dhe ka pas kërkesa që na janë prezantuar edhe nga Kuvendet Komunale për themelimin e këtij Universiteti dhe e kemi parë të arsyeshme që këtë vendim ta diskutojmë sot me anëtarët e Komisionit. Ai theksoi se është e vërtetë që ka mungesë të kuadrit në këtë Universitet sepse është një Universitet i ri por një vendim të tillë në parim e përkrahi.

R e k o m a n d i m

1. I rekomandohet Kuvendit të ratifikojë Vendimin e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për themelimin e Universitetit Publik të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj si Institucion publik i arsimit të lartë.

2. Arsyetimin e Raportit me rekomandim e paraqet Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

A r s y e t i m

Komisioni, shqyrtoi Vendimin e MASHT për themelimin respektivisht avansimin e Fakultetit në Universitet Publik të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, si institucion publik i arsimit të lartë dhe konstatoi se Vendimi për themelimin e Universitetit Publik, është në pajtim me nenin 9 paragrafi 1 të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës.

Komisioni me shumicë votash përkrahu Vendimin e MASHT për themelimin e Universitetit Publik, dhe vlerësoi se vendime e tilla kontribuojnë në interes të përgjithshëm të përfshirjes së të rinjëve të këtij rajoni në arsimin e lartë.

Nait Hasani, tha se sa i përket raportit të Agjencisë për Trashëgimin Kulturore, kemi një vendim të kryesisë së Kuvendit sipas të cilit raportet e Agjencive të cilat nuk kanë borde nuk shqyrtohen.

Ismajl Kurteshi, tha se ky nuk është një vendim i kryesisë por është një shkresë e një zyrtari që thotë se në konsultim me sekretarin e Kuvendit është marrë ky vendim.

Nait Hasani, tha se ne kemi kërkuar nga kryetari i Kuvendit që të procedohet lista e kandidatëve për Këshillin e Trashëgimisë Kulturore ose të filloje edhe një herë procedura për përzgjedhjen e bordit të këtij Këshilli.

Shukrije Bytyqi, tha se kjo listë duhet të përcjellët në Kuvend sepse prej vitit 2010 ky Këshill nuk ka bord. Dhe sa i përket raportit të këtij Këshilli tha se duhet ta shqyrtojmë këtë raport sepse përderisa ata kanë një buxhet ne duhet të dimë se ku është shpenzuar.

Bekim Haxhiu, tha se pavarësisht se ky bord nuk është komplet dhe ai raport është përfunduar nga ata pak anëtarë që janë të Këshillit, ne duhet ta trajtojmë këtë raport dhe ti japim vërejtjet edhe në seancë sepse një çështje kaq serioze siç është Trashëgimia Kulturore nuk duhet të neglizhohet në këtë formë. Sa i përket plotësimit të Këshillit tha se ne i kemi propozimet, të cilat dy herë në seancë nuk kanë kaluar dhe tani kemi marr vendim që ti adresohemi kryesisë së Kuvendit që ose ti procedojë edhe një herë emrat që ne i kemi propozuar për seancë ose të rishpallet konkursi.

Ismajl Kurteshi, tha se unë jam që pavarësisht se a ka apo ajo bord ta shqyrtojmë raportin e këtij Këshilli sepse mjetet janë shpenzuar dhe duhet të dimë se ku dhe a janë të arsyeshme ato shpenzime që janë bërë.

Salih Morina, tha se unë pajtohem që ky raport të shkoj në Kuvendin e Kosovës pavarësisht nga kërkesa e sekretarit sepse kemi të bëjmë me një shumë financiare që e ndan Kuvendi i Kosovës për Trashëgimin Kulturore dhe në mbledhjen e radhës të futet si pikë e rendit të ditës.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 12:00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani